



Kam pasë fatin me e takue ma së parit Willy Kamsin në fundin e viteve '80, asokohe jetonte edhe i jati, ekonomisti e patrioti Gjon Kamsi, miku e bashkëpuntori i ngushtë i Luigj Gurakuqit. Ma vonë si student pata rasën me i ndejtë afër në bibliotekën e Institutit të Lartë Pedagogjik e me mësue prej tij hapat e parë të artit të përpunimit të librit, tue zbulue njikohsisht botën e

mrekullueshme të studimeve albanologjike.

W. Kamsi ka lindë në Bari me 17 dhjetor 1926, në një familje që rrjedh prej Engjëllorëve të Drishtit, i ati, Gjoni, autor shkrimesh të shumta me karakter ekonomik, ka qenë gjatë Luftës së Dytë Botnore këshilltar i Bankës Kombtare. Tue qenë ende student liceu, nën drejtimin e prof. Filip Fishtës, Willy punoi në Bibliotekën e Institutit të Studimeve Shqiptare në Tiranë. Në vitin 1948 mori maturën në Gjinnazin e Tiranës. Në vitin 1953 familja u dëbue prej regjimit komunist nga Tirana në Shkodër, ku mbas dhjetë vjetësh ai nisi punën si përgjegjës i Bibliotekës së Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, ku punoi deri në vitin 1990. Gjatë 27 vjetëve fondi i kësaj biblioteke u rrit nga 10 mijë vëllimet fillestare në 120 mijë libra e koleksione revistash, tue krijue njikohësisht prej themelit një fond albanobalkanologjik që ende sot, mbas Bibliotekës Kombtare, mbahet ndër ma të mirët në Shqipëri, me libra të blemë kryesisht nga familje të vjetra shkodrane. Tue pasë ndjekë studimet e nalta, mori në vitin 1975 diplomën në histori-geografi. Mbas ramjes së komunizmit u emnue ambasadori i parë i Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë, tue paraqitë letrat kredenciale me 22 prill 1993. Ka bashkëpunue ndër vite me revista të ndryshme si: *Studime gjuhësore* (Tiranë), *Monumentet* (Tiranë), *Buletini shkencor* (Shkodër), *Kumtari i Muzeut* (Shkodër), *Phoenix* (Shkodër). Ka përkthye vepra të ndryshme albanologjike nga italishtja, frëngjishtja e anglishtja. Ndër to ka botue prej Ernest KOLIQI, *Sprovë letërsie shqiptare* (Prishtinë, 2003), prej Át Jak (Luigj) MARLEKAJ, *Pjetër Bogdani dhe Shqipëria e kohës së tij* (Shkodër, 2008), prej Mario ROQUES, *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe dhe Fjalori i Frang Bardhit* (Shkodër, 2011), ndërsa prej Imz. Ernesto COZZI trí studime në lidhje me fiset shqiptare, gjakmarrjen dhe gruen shqiptare e prej Gorrit T.A. GOSLINGA, *Holandezët në Shqipëri* mbesin ende të pabotueme.

Në vitin 2005 u paraqit në Kuvendin Ndërkombtar të mbajtur pranë Universitetit të Napolit "L'Orientale" me kumtesën *Thirrja e krishtenë dhe europjane e Gjergj Kastriotit Skanderbegut*.

W. Kamsi mban medaljen "Naim Frashëri" për merita pune në fushën bibliotekare (1987); asht Kalorës i Kryqit të Madh të Urdhnit të Shën Gregorit të Madh (1995) dhe Kalorës i Urdhnit të Hyllit të Solidaritetit Italian (2005).

E përkohshmja *Shejzat* tue i urue njizanit studiuesit Willy Kamsi edhe shumë vite tjera aktivitet të frytshëm, shpreson që ma së fundit të shohin dritën e botimit punimet e tija origjinale si dhe veprat e tjera që ka përkthye e kujdesue me cenë e aftësi të rrallë.

On the 90th anniversary of scholar Willy Kamsi

Shejzat this time pays tribute to Albanian historian and scholar Willy Kamsi on his 90th anniversary. Born on 17 Dec 1926 in Bari, Italy, while his parents were in political exile, he is son of Gjon Kamsi, one of the closest collaborators of Luigi Gurakuqi and an exponent of the Christian Democratic Party (Alb. *Opozita*) himself. Willy and his sister Myriam grew up with the long-cherished desire to see the homeland. When they finally returned in 1939, the family settled in Tirana. Though still in his teens, Willy Kamsi started working with Prof. Filip Fishta, Albanologist in the library of the Institute for Albanian Studies. Banished from Tirana in the aftermath, the family returned to its hometown, Shkodra. In fact, the Kamsi are descendants of the households *Kambisi* and *Engjulli*, native of Drishti and Shkodra who are both mentioned in many documents as early as the 15th century.

In Shkodra Willy Kamsi began work as librarian at the Institute Luigi Gurakuqi. In ten years the department of Albanology and Balkanology that he was so painstakingly taking care of became the hearth around which Albanologists got together. Though paranoia was rife on all sides, Willy Kamsi remained adamant in his scientific vocation and went on persuading offsprings of prominent families in Shkodra to contribute to the enrichment of the library with rare books and newspapers. Nobody can recall a harsh word ever passing his lips, not even when the pressure of the regime was unbearable.

After the fall of Communism, Willy Kamsi was appointed Ambassador of the Republic of Albania to the Holy See in 1993, the first of the democratic era.

While wishing to the author a long and healthy life, *Shejzat* brings here three papers by Kamsi, hoping that the author will publish many other studies in the near future.

A.N.